



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë - Ministarstvo Industrije, Preduzetnistva i
Tergovine- Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Bazuar në Udhëzimin Administrativ (MTI) nr. 01/2018, Vendimin nr. 5235 datë 15.07.2021 dhe Vendimin nr. 393/01 datë 09.06.2023 me qëllim të zvogëlimit të deficitit tregtar dhe përmirësimit të kapaciteteve prodhuese të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NVM), rritjen e investimeve, rritjes së eksportit, konkurrueshmërisë dhe hapjen e vendeve të reja të punës, Ministria Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) shpallë:

**Thirrje publike për subvencionim të NVM-ve për blerjen e makinerive
prodhuese /përpunuese**

MINT/KIESA do të mbështes në subvencionim me mjete financiare ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme. Të interesuarit për aplikim në këtë thirrje duhet të jenë qytetar të Republikës së Kosovës.

Buxheti i planifikuar për subvencionim për këtë thirrje është 1,700,000.00€. Në secilin rast Autoriteti Kontraktues (MINT) rezervon të drejtën të mos shpërndajë të gjitha mjetet në dispozicion.

Granti do të ndahet në tri Lot-e, si vijon:

Loti 1 - Ndërmarrjet mikro (të punësuar deri në 9 punëtorë)

Buxheti total për kategorinë e ndërmarrjeve mikro është 700,000.00€

Loti2 - Ndërmarrjet e vogla (të punësuar 10 deri në 49 punëtorë)

Buxheti total për kategorinë e ndërmarrjeve të vogla është 700,000.00€

Loti3 - Ndërmarrjet e mesme (të punësuar 50 deri në 249 punëtorë)

Buxheti total për kategorinë e ndërmarrjeve të mesme është 300,000.00€

Për të gjitha procedurat e aplikimit dhe dokumentacionin e nevojshëm, MINT/KIESA ka përgatitur udhëzues për aplikant të cilët do t'i gjeni në linkun: <https://mint.rks-gov.net/> dhe <https://kiesa.rks-gov.net/> ndërsa për të aplikuar online kliko këtu: <https://kosova.rks-gov.net/502>

Thirrja për aplikim është e hapur prej datës 27.03.2024 deri 19.04.2024.